

Këshilli Koordinues i Diasporës takim me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve



Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës (KKD) zhvilluan një takim online me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, z. Ilirjan Celibashi, për të diskutuar për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë vendit. Sipas rendit të ditës, diskutimi u hap nga Kryetari i Këshillit Koordinues të Diasporës, z. Mark Gjonaj, i cili e falenderoi Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve për kohën dhe përkushtimin që po tregon ndaj kësaj çështjeje, si dhe tha se Këshilli Koordinues i Diasporës e shikon votën e Diasporës si një pikë shumë të rëndësishme në detyrën që ju keni marrë përsipër. "Thesari i vërtetë i Shqipërisë janë vetë shqiptarët, kudo që jetojnë në botë, ndaj dhe vota e Diasporës është shumë e rëndësishme. Për këtë arsye do donim të dinin se në cilën pikë kanë arritur zhvillimet në lidhje me votën e Diasporës", tha Gjonaj. Z. Celibashi siguroi anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës për angazhimin e tij si Komisioner Shtetëror dhe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për realizimin e votës së bashkëkombësve tanë që jetojnë jashtë shtetit. Anëtarët e tjerë të KKD gjithashtu ndanë me Komisionerin Shtetëror pyetjet dhe shqetësimet e tyre në lidhje me procesin e realizimit të votës së Diasporës.


Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#).

Botimi dygjuhësh shqip-anglisht

“Sirena e vogël” / “Udhëtimet e Guliverit”, falas nga QBD



“Sirena e vogël” dhe “Udhëtimet e Guliverit”, dy përralla mjaft të dashura për fëmijët, pjesë e serisë “Klasikët Dygjuhësh” – projekt i Qendrës së Botimeve për Diasporën, flasin shqip dhe anglisht. “Sirena e vogël”, një ndër përrallat e famshme të shkruara autori danez Hans Christian Andersen u botua për herë të parë në vitin 1837, si pjesë e një koleksioni përrallash për fëmijë. Është përshtatur në media të ndryshme, si: teatër muzikor, balet, opera dhe film. Ekziston edhe një statujë që portretizon sirenën në Kopenhagë, Danimarkë, ku historia u shkrua dhe u botua për herë të parë. Përralla “Udhëtimet e Guliverit” është një përshtatje nga vepra satirike me të njëjtin titull e shkrimtarit dhe klerikut irlandez Jonathan Swift, botuar më 1726. Konsiderohet si një klasik në letërsinë botërore për fëmijë dhe jo vetëm. Vepra pati një sukses të menjëhershëm që në krye të herës. Dramaturgu anglez John Gay u shpreh për veprën se libri “është lexuar botërisht, nga këshilli i kabinetit deri në çerdhe”.

“Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës”



“Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës” është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale të ndryshme në diasporë.

Turqi / Mësuesit e gjuhës shqipe marrin tekste mësimore të dërguara nga QBD-ja



Bursa, Turqi / 282 tekste shkollore dhe plotësuese të paracaktuara për mësimdhënien e gjuhës dhe kulturës shqiptare në Diasporë, dërguar falas nga QBD kanë mbërritur në ambasadën shqiptare në Turqi dhe tashmë janë dorëzuar te mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare atje. Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Ankara z. Kastriot Robo ka vizituar Shkollën Publike në Bursa, mirëpritur nga drejtori i Shkollës Publike Ali Celal Elmaz, zëvendës drejtori Kenan Doğru, mësuesja e Gjuhës Shqipe në këtë shkollë dhe Ambasadore e Kombit znj. Teuta Tabaku, si dhe nxënësit të Kurseve të Gjuhës Shqipe. Ambasadori dorëzoi tekste didaktike për vitin shkollor 2020-2021 dërguar nga QBD-ja nën kujdesin e nga Ministrit të Shtetit për Diasporën, si dhe certifikatat e mbarimit të nivelit A2 të nxënësve. Përveç teksteve shkollore dhe një larmie titujsh plotësues për nxënësit e komunitetit shqiptar atje, në dërgesë përfshihet edhe risia “Botimet Dygjuhëshe”, projekt i QBD-së, me fjalorët dygjuhësh dhe serinë e përrallave klasike dygjuhëshe, të cilat synojnë ta bëjnë mësimin e gjuhës edhe më të lehtë e argëtues. Veç tyre, Qendra e Botimeve për Diasporën ofron akses online të botimeve të saj në faqen zyrtare web: <http://qbd.gov.al/> si dhe të platformës së mësimit shqip “Schoolme”, tashmë në dispozicion të mësuesve për mësimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare në Diasporë.

Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

Greqi / Vijon dorëzimi i teksteve për mësimdhënien në Diasporë dërguar nga Qendra e Botimeve për Diasporën



Vijon dorëzimi i librave për mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporën shqiptare në Greqi, dërguar nga Qendra e Botimeve për Diasporën, nën kujdesin Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe me mbështetjen e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Oficerja Koordinuese për Diasporën në Athinë, znj. Joneda Dodaj, mirëpriti në ambientet e ambasadës shqiptare në Athinë, mësuesen e nderuar të kursit të mësimin plotësues të gjuhës shqipe pranë Shtëpisë shqiptare “Porta” në Athinë dhe njëkohësisht Nënkryetaren e Lidhjes së Mësuesve Shqiptarë në Greqi, znj. Alma Zekollari, si dhe kryetaren e shoqatës “Emigranti”, Patra dhe paralelisht, aktiviste shoqërore dhe mësuese, znj. Kristiana Veliu, të cilës iu dorëzuan librat për Shkollën e Gjuhës Shqipe “Naim Frashëri”.

Aplikacioni Gazeta “Diaspora Shqiptare”



App store [këtu](#): Play store [këtu](#).

Regjistri shtetëror i mësuesve të gjuhës shqipe, shtyhet afati i regjistrimit



Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar ka njoftuar shtyrjen e afatit të aplikimit për regjistrim në regjistrin shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë. Sipas njoftimit të kësaj agjencie, kandidatët të cilët dëshirojnë të bëhen pjesë e regjistrin shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në Diasporë, duhet të aplikojnë për t’u regjistruar dhe të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar sipas afateve të ripërcaktuara në këtë njoftim. Afati përfundimtar i dorëzimit të dokumenteve është data 30 nëntor 2020. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve të cituara në njoftim mund të bëhet përmes adresës postare: ASCAP, Rruga “Naim Frashëri”, Nr. 37, Tiranë ose online në faqen zyrtare elektronike të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

“Raporto” problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#).